

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Zbulimi / *el-Mukaashefe* / **المُكَاشَفَةُ**

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Seksioni i Realiteteve

Për sa i përket seksionit të realiteteve¹, kjo ka dhjetë kaptina: zbulimi, dëshmimi, të parët, jeta, ngushtimi, zgjerimi, dehja, esëllima, lidhja, ndarja.

Allahu ﷻ tha:

"فَأَوْحَىٰ إِلَىٰ عَبْدِهِ مَا أَوْحَىٰ"

"Dhe i shpalli robit të Vet atë çfarë i shpalli."² (en-Nexhm, 10)

¹ A na ofrojnë materia dhe dukuritë përreth nesh një llogari të mjaftueshme të realitetit të kësaj ekzistence? Mes idealistëve që shkuan aq larg sa të mohojnë ekzistencën e tyre të njëmendtë dhe materialistëve që i konsideruan të mjaftueshme për ekzistencën tonë, Islami vërteton realitetin e ekzistencës materiale, por dënon ata që nuk shohin përtej saj. Allahu thotë:

"Ata dinë atë që është e dukshme nga jeta e kësaj bote, por janë të pavetëdijshëm për jetën e përtejme (ahiretin)." (er-Rum, 7)

Allahu lavdëron ata që besojnë në atë që është përtej përvojës së tyre empirike – të padukshmen, për realitetin e së cilës janë vendosur provat dhe vetëdija njerëzore s'mund ta mohojë. Allahu thotë:

"... një udhëzim për ata që janë të vetëdijshëm për Allahun; ata që besojnë në të padukshmen." (el-Bekare, 3-5)

Në këtë seksion, Imam el-Harawi trajton realitetet më të larta të kësaj ekzistence dhe arrijen e një vetëdijeje më të lartë për to.

² Lidhja e dukshme mes ajetit dhe temës është se Shpallja është forma më e lartë e zbulimit të realiteteve që zbresin vetëm në zemrat e pejgamberëve dhe të Dërguarve të përzgjedhur. Duhet të thuhet se llojet të tjera të zbulimit asnjëherë s'mund të krahasohen me këtë formë më të lartë në realitetin, sigurinë/bindjen, shtrirjen ose rëndësinë e tyre.

Zbulimi është këmbim sekretesh mes dy të brendshmeve intime³. Në këtë kontekst, kjo i referohet kapërcimit të perdes në realitet⁴. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është një zbulim që çon në të kuptuarit e saktë⁵. Kjo nuk është e qëndrueshme (në këtë nivel). Kur kjo të jetë e herëpashershme, por që nuk priset nga shkapërderdhja (*teferruk*), edhe nëse stacioni i tij turbullohet përkohësisht, ai ka arritur nivelin ku asnjë ndërhyrje s’do ta shpërqendrojë⁶, asnjë shkak s’do ta mënjanojë papritmas dhe asnjë interes personal s’do ta pengojë⁷. Ky është niveli i *el-Kaasid* (Synuesi).

Kur kjo bëhet e qëndrueshme, përbën nivelin e dytë.

Për sa i përket nivelit të tretë, ky është zbulimi i realitetit, jo dija rreth tij. Ky është një zbulim i cili nuk lë shenjë⁸ që tregon për kënaqje, nuk detyron për pushim, nuk lë vend për imazhe⁹. Fundi i këtij zbulimi është dëshmimi¹⁰.

³ Kjo ka të bëjë me këmbimin e sekreteve më të holla mes dy miqve intim. Këmbimi këtu bëhet prej të brendshmes tek e brendshmeja, prandaj shohim përdorimin e *mutebaatinejn*, që nënkupton dy miq me të brendshmet (*baatin*) e tyre të lidhura.

⁴ Perdet e egove tona dhe dukuritë përreth nesh që na pengojnë të shohim realitetin e ekzistencës sonë; gjithëfuqishmërinë, epërsinë dhe përparësinë e Zotit; të krijuarit tonë prej Tij nga asgjëja, nevojën tonë të pamasë për Të, dhe kthimin tonë përfundimtar tek Ai.

⁵ Domethënë të kuptuarit e së vërtetës ashtu siç është, ndreqjen e besimeve tona, dhe të kuptuarit e vullnetit detyruar të Zotit, që na motivon për shtegun e drejtë dhe përpunimin e sjelljes sonë. Zbulimi më i madh është t’i tregosh robit detajet e shtegut, përfshirë dhe dallimin mes të vërtetës dhe të pavërtetës, si dhe të kuptuarit e shtegut më të shkurtër për te Zoti dhe të metat e *nefsit* që mund të shkaktojnë dëm ose vonim. Ky zbulim është më i mirë sesa zbulimi i një të padukshmeje relative (siç është ajo se çfarë ka në një kuti të mbyllur ose çfarë ka prapa derës) që u mundësohet disa njerëzve. Zbulimi i këtillë mund t’u ndodhë evlijave (të afërmeve) të Rrahmaanit dhe atyre të Shejtanit, ndonëse burimi, rëndësia, dhe qëllimi i tij nuk janë të njëjta.

⁶ Grabitësit e rrugëve nuk do ta bëjnë atë ta ndryshojë rrugën.

⁷ Aspirata, vendosmëria dhe vetëpërmbajtja e tij nuk do të asgjësohen nga ndonjë interes i ulët i tij.

⁸ S’ka mbetur gjë të identifikohet nëpërmjet shenjave dhe përshkrimeve në këtë nivel që shejhu (*el-Harawi*) ia kushton *fana*-së (vetasgjësimi).

⁹ Imazhet i referohen realiteteve të jashtme të materies dhe dukurive kalimtare, përfshirë edhe mbetjet e vetes (egos).

¹⁰ Shih kaptinën e radhës për shkallën (stacionin) e dëshmimit.